



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MBROJTJES



# 9-15 SHKURT

# JAVA E MBROJTJES





# KORRIDORI VIII

## KORRIDORI 8, ZYRTARISHT NË INFRASTRUKTURËN KRITIKE TË NATO-S

Korridori 8, me pikënisje në kompleksin portual Durrës - Porto Romano dhe dalje në Detin e Zi është përfshirë zyrtarisht në planet dhe infrastrukturën kritike ushtarake të NATO, duke u njohur si korridor sigurie për mbrojtjen kolektive të Aleancës. Vendimi u bë i ditur nga ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, në përfundim të Ministerialit të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare, të mbajtur në Bruksel.

★★★★★

[mod.gov.al](http://mod.gov.al)

JM

# MINISTRI VENUGU NË KONFERENCËN E SIGURISË SË MYNIHUT

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në Konferencën e Sigurisë së Mynihut, një nga platformat më të rëndësishme globale për sigurinë. Në fokus të diskutimeve ishte forcimi i mbrojtjes dhe rritja e bashkëpunimit si garanci për stabilitet dhe siguri në një mjedis gjithnjë e më sfidues.

JM





# BISEDIME ME HOMOLOGËT KOSOVARË DHE KROATË

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, u takua me homologun kroat Ivan Anušić dhe me ministrin e Mbrojtjes të Kosovës Ejup Maqedonci, në Konferencën e Sigurisë në Mynih. Ky takim erdhi në një moment kur mjedisi i sigurisë në Evropë dhe rajon karakterizohet nga dinamika të shtuara dhe nevoja për përgjigje të koordinuara. Diskutimet u fokusuan në thellimin e bashkëpunimit në mbrojtjen e përbashkët, rritjen e ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura, zhvillimin e Industrisë Ushtarake dhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme mbrojtëse.

★★★★★




# TAKIMI TREPALËSH NDËRMJET SHEFAVE TË SHTABEVE

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në qytetin e Shkodrës takimin trepalësh në nivel të Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kroacisë, gjenerallejtënant Tihomir Kundid, dhe Republikës së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari. Qëllimi i takimit ishte identifikimi i fushave konkrete të bashkëpunimit ushtarak, që mund të përmirësojnë ndërveprueshmërinë dhe gatishmërinë operacionale ndërmjet forcave të armatosura.

★★★★★





# MEMORANDUM SHQIPËRI – URDHRI I MALTËS

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Urdhri Sovran i Maltës nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, me synim rritjen e gatishmërisë dhe forcimin e mekanizmave të reagimit për emergjencat civile, si dhe përmirësimin e mbështetjes mjekësore në situata krize.





# BATALIONI XHENIO NDËRTON URËN NË SELENICË

Kompania e Urave në Batalionin e Xhenios, po ndërhyr për ndërtimin e urës metalike tip “Bailey”, në bashkinë Selenicë. Ura me gjatësi 18 m, seksion 2/1 do t’u shërbejë banorëve të fshatrave Bashaj, Matogjin, Vermik dhe Verbas, duke lehtësuar realizimin e aktiviteteve të përditshme dhe siguruar aksesin drejt shërbimeve bazë.

JM





# FORCA DETARE NIS KONTINGJENTIN NË MISIONIN E NATO-S

Kontingjenti i XI-të i Forcës Detare u përçoll nga Pashalimani për t'iu bashkuar misionit të NATO "Aegean Sea" në Detin Egje. Ky angazhim thekson profesionalizmin e Forcës Detare dhe kontributin e Shqipërisë në forcimin e sigurisë detare dhe bashkëpunimit me vendet aleate.

JM





# FORCA TOKËSORE VIJON DHURIMIN VULLNETAR TË GJAKUT

Në bashkëpunim me Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, repartet e Forcës Tokësore zhvilluan ditët e dhurimit vullnetar të gjakut në Regjimentin e Këmbësorisë së Jugut, në b2k Gjirokastrë dhe b3k Korçë. Efektivët iu përgjigjën me gatishmëri kësaj nisme humanitare, duke kontribuar në shpëtimin e jetëve dhe në shërbim të komunitetit.

